



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.792/1 prot.

Peshkopi, më 10.09.2025

Lënda: Për vendimin nr.36, datë 03.09.2025 të Këshillit Bashkiak Dibër.

BASHKISË DIBËR
KËSHILLIT BASHKIAK DIBËR

DIBËR

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, neni 16, pas verifikimit për efekt ligjshmërie të vendimit të Këshillit Bashkiak Dibër nr.36, datë 03.09.2025 **“Për miratimin e planit të integritetit 2025-2028”**, vendosa:

Miratimin në parim të vendimit objekt verifikimi dhe shqyrtimi në kushtet e zbatimit të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën përkatëse, nën përgjegjësinë direkte administrativo-ligjore të strukturave të posaçme të Bashkisë Dibër që paraqesin për miratim projekt akte të kësaj natyre.

PREFEKTI

Nexhbedin SHEHU



PREFEKTURA DIBËR
Ardhur
Nr. 792 di 04.09.25



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

Nr. 3401 Prot

Peshkopi, më 04.09.2025

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër **Nr. 36**

Datë: 03.09.2025 si dhe projekt-vendimin **nr.02 Datë 27.08.2025**

“PËR MIRATIMIN E “PLANIT TË INTEGRITETIT 2025-2028”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Ilir Elezi



Kupja
04-09-2025
[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 36 Datë 03 / 09 /2025

“PËR MIRATIMIN E “PLANIT TË INTEGRITETIT 2025-2028”.

Bazuar në ligjin nr.139/2015 për vetëqeverisjen vendore, parimet e qeverisjes së mire.Ligji nr.152/2013 për nënpunësin civil,etika,integriteti i nënpunësve strategjia kombëtare kundër korupsionitn plane integriteti në nivel vendor ligjir nr.90/2012 për administratën shtetërore, parandalimi i sjelljes së pahijshme, Ligji nr 9367/2005 për konfliktin e interesit, parandalimi i abuzimeve me detyrën Ligji nr 119/2014 për të drejtën e informimit, transparenca dhe llogaridhënja. Këshilli Bashkiak Dibër në mbledhjen e datës **03.09.2025** me 16 vota pro 0 kundër 7 apstenim :

VENDOSI:

1. Të miratoj Planin e Integritetit të Bashkisë Dibër 2025-2028.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Integritetit Europian dhe Ndhmës së Huaj,Bashkia Dibër.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër.
4. Vendimi u shpall më datë **03.09.2025**.

Zv/Kryetar i Këshillit Bashkiak





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

DREJTORIA INTEGRIMIT EUROPIAN DHE NDIHMËS SË HUAJ

PROJEKT VENDIM

Nr. 02, datë 27.08 2025

“Për miratimin e Planit të Integritetit 2025-2028”

Bazuar në Ligjin nr.139/2015 për vetëqeverisjen vendore, Parimet e qeverisjes së mire. Ligji nr.152/2013 për nëpunësin civil, Etika, integriteti i nëpunësve ,Strategjia Kombëtare Kundër Korrupsionit, Plane integriteti në nivel vendor Ligji nr. 90/2012 për administratën shtetërore, Parandalimi i sjelljes së pahijshme, Ligji nr. 9367/2005 për konfliktin e interes, Parandalimi i abuzimeve me detyrën, Ligji nr. 119/2014 për të drejtën e informimit, Transparenca dhe llogaridhënia, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë Dibër të:

1-Miratojë e Planin e Integritetit të Bashkisë Dibër 2025-2028.

PËR BASHKINË DIBËR

DREJTORIA INTEGRIMIT EUROPIAN
DHE NDIHMËS SË HUAJ
Ridjan KATA

DREJTORIA JURIDKE
Ismet SARAÇI

KRYETARI BASHKISË DIBËR
RAHIM SPAHIU
NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZV.KRYETARI
LORENC CIBAKU





BASHKIA DIBER

RELACION SHPJEGUES

Për Planin e Integritetit të Bashkisë Dibër (2025–2028)

Dokument shoqërues për t'u paraqitur Këshillit Bashkiak

Ky relacion hartohet si dokument shpjegues përpara Këshillit Bashkiak Dibër, me qëllim shoqërimin e Planit të Integritetit dhe Antikorrupsionit 2025–2028. Ai përmbledh objektivat, përmbajtjen, procesin e hartimit dhe rëndësinë që ky plan ka për funksionimin e administratës dhe për qytetarët e Bashkisë Dibër.

Plani i Integritetit nuk është thjesht një dokument formal, por një mjet i domosdoshëm për të ndërtuar një administratë vendore të ndershme, të hapur dhe efikase. Ai lidhet drejtpërdrejt me detyrimet që burojnë nga kuadri ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe nga mekanizmat e performancës të mbështetur nga AMVV, Ministria e Financave dhe donatorë ndërkombëtarë.

Plani është hartuar përmes një procesi gjithëpërfshirës, të mbështetur në metodologjinë e vlerësimit të riskut për integritet, si dhe është përgatitur nga grupi i punës ngritur në Bashki. Ky proces përfshiu disa faza të rëndësishme:

- Vlerësimi i situatës aktuale: Analizë e funksioneve dhe praktikave të administratës, përmes intervistave, pyetësorëve elektronikë dhe fokus-grupeve. Janë identifikuar sektorët më të ekspozuar ndaj korrupsionit.
- Analiza e riskut: Hartimi i një harte të risqeve, duke i kategorizuar ato sipas nivelit të lartë, mesatar apo të ulët.
- Formulimi i objektivave strategjikë: Për secilin risk janë përcaktuar masa parandaluese, përgjegjësit institucionale dhe afatet e zbatimit.
- Përgatitja e planit të veprimit: Masat janë prioritarizuar, janë përcaktuar burimet e nevojshme dhe janë vendosur tregues monitorimi.
- Pjesëmarrja e palëve të interesit: Janë organizuar konsultime me qytetarë, këshillin bashkiak, shoqërinë civile dhe drejtues administrativë.

Plani është i strukturuar mbi tre shtylla kryesore:

1. Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator dhe etik – përmirësimi i rregulloreve, kodit të etikës dhe mekanizmave të sinjalizimit; trajnime për stafin mbi integritetin; publikimi i informacionit për qytetarët; forcimi i njësisë së performancës.

2. Përmirësimi i procedurave të kontrollit dhe monitorimit – konsolidimi i mekanizmave të auditimit, forcimi i transparencës në vendimmarrje, prokurime, menaxhim financiar, burime njerëzore dhe pronë publike.

3. Rritja e besimit të qytetarëve – publikimi i rregullt i informacionit, zhvillimi i konsultimeve me komunitetin, vendosja e standardeve të matshme të shërbimeve, rritja e llogaridhënies dhe përfshirjes qytetare.

Plani i Integritetit për Bashkinë Dibër mbart disa rëndësi kryesore:

- Përputhshmëria ligjore – është një detyrim i qartë që buron nga ligji shqiptar dhe kuadri ndërkombëtar.
- Performanca dhe financimi – lidhet ngushtë me Grantin e Bazuar në Performancë.
- Përmirësimi i shërbimeve – garanton një administratë më efikase, më transparente dhe më të përgjegjshme.
- Rritja e besimit qytetar – përforcon lidhjen midis qytetarëve dhe institucioneve vendore.

Plani shoqërohet me një plan veprimi të detajuar, ku për çdo risk përcaktohen masat, përgjegjësit, afatet dhe indikatorët e monitorimit.

- Monitorimi do të kryhet çdo vit përmes raporteve të dedikuara.
- Raportimi do të realizohet të paktën çdo gjashtë muaj.
- Rishikimi i planit parashikohet të bëhet periodikisht.

Plani i Integritetit 2025–2028 përbën një instrument kyç për modernizimin e administratës vendore. Këshilli Bashkiak luan një rol thelbësor për miratimin dhe mbështetjen politike të planit, për mbikëqyrjen e zbatimit të masave dhe për nxitjen e një kulture llogaridhënieje. Ky është një vendim i rëndësishëm politik dhe institucional që garanton që Bashkia Dibër të ecë drejt një administrate të ndershme, transparente dhe të besueshme.

Ridjan Kutoi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

DREJTORIA INTEGRIMIT EUROPIAN DHE NDIHMËS SË HUAJ

PROJEKT VENDIM

Nr. 02, datë 27.08.2025

“Për miratimin e Planit të Integritetit 2025-2028”

Bazuar në Ligjin nr.139/2015 për vetëqeverisjen vendore, Parimet e qeverisjes së mire. Ligji nr.152/2013 për nëpunësin civil, Etika, integriteti i nëpunësve ,Strategjia Kombëtare Kundër Korrupsionit, Plane integriteti në nivel vendor Ligji nr. 90/2012 për administratën shtetërore, Parandalimi i sjelljes së pahijshme, Ligji nr. 9367/2005 për konfliktin e interes, Parandalimi i abuzimeve me detyrën, Ligji nr. 119/2014 për të drejtën e informimit, Transparenca dhe llogaridhënia, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë Dibër të:

1-Miratojë e Planin e Integritetit të Bashkisë Dibër 2025-2028.

PËR BASHKINË DIBËR

DREJTORIA INTEGRIMIT EUROPIAN
DHE NDIHMËS SË HUAJ
Ridjan KATA

DREJTORIA JURIDKE
Ismet SARACI

**KRYETARI BASHKISË DIBËR
RAHIM SPAHIU
NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZV.KRYETARI
LORENC CIBAKU**





BASHKIA DIBER

RELACION SHPJEGUES

Për Planin e Integritetit të Bashkisë Dibër (2025–2028)

Dokument shoqërues për t'u paraqitur Këshillit Bashkiak

Ky relacion hartohet si dokument shpjegues përpara Këshillit Bashkiak Dibër, me qëllim shoqërimin e Planit të Integritetit dhe Antikorrupsionit 2025–2028. Ai përmbledh objektivat, përmbajtjen, procesin e hartimit dhe rëndësinë që ky plan ka për funksionimin e administratës dhe për qytetarët e Bashkisë Dibër.

Plani i Integritetit nuk është thjesht një dokument formal, por një mjet i domosdoshëm për të ndërtuar një administratë vendore të ndershme, të hapur dhe efikase. Ai lidhet drejtpërdrejt me detyrimet që burojnë nga kuadri ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe nga mekanizmat e performancës të mbështetur nga AMVV, Ministria e Financave dhe donatorë ndërkombëtarë.

Plani është hartuar përmes një procesi gjithëpërfshirës, të mbështetur në metodologjinë e vlerësimit të riskut për integritet, si dhe është përgatitur nga grupi i punës ngritur në Bashki. Ky proces përfshiu disa faza të rëndësishme:

- Vlerësimi i situatës aktuale: Analizë e funksioneve dhe praktikave të administratës, përmes intervistave, pyetësorëve elektronikë dhe fokus-grupeve. Janë identifikuar sektorët më të ekspozuar ndaj korrupsionit.
- Analiza e riskut: Hartimi i një harte të risqeve, duke i kategorizuar ato sipas nivelit të lartë, mesatar apo të ulët.
- Formulimi i objektivave strategjikë: Për secilin risk janë përcaktuar masa parandaluese, përgjegjësit institucionalë dhe afatet e zbatimit.
- Përgatitja e planit të veprimit: Masat janë prioritarizuar, janë përcaktuar burimet e nevojshme dhe janë vendosur tregues monitorimi.
- Pjesëmarrja e palëve të interesit: Janë organizuar konsultime me qytetarë, këshillin bashkiak, shoqërinë civile dhe drejtues administrativë.

Plani është i strukturuar mbi tre shtylla kryesore:

1. Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator dhe etik – përmirësimi i rregulloreve, kodit të etikës dhe mekanizmave të sinjalizimit; trajnime për stafin mbi integritetin; publikimi i informacionit për qytetarët; forcimi i njësisë së performancës.

2. Përmirësimi i procedurave të kontrollit dhe monitorimit – konsolidimi i mekanizmave të auditimit, forcimi i transparencës në vendimmarrje, prokurime, menaxhim financiar, burime njerëzore dhe pronë publike.

3. Rritja e besimit të qytetarëve – publikimi i rregullt i informacionit, zhvillimi i konsultimeve me komunitetin, vendosja e standardeve të matshme të shërbimeve, rritja e llogaridhënies dhe përfshirjes qytetare.

Plani i Integritetit për Bashkinë Dibër mbart disa rëndësi kryesore:


- Përputhshmëria ligjore – është një detyrim i qartë që buron nga ligji shqiptar dhe kuadri ndërkombëtar.
- Performanca dhe financimi – lidhet ngushtë me Grantin e Bazuar në Performancë.
- Përmirësimi i shërbimeve – garanton një administratë më efikase, më transparente dhe më të përgjegjshme.
- Rritja e besimit qytetar – përforcon lidhjen midis qytetarëve dhe institucioneve vendore.

Plani shoqërohet me një plan veprimi të detajuar, ku për çdo risk përcaktohen masat, përgjegjësit, afatet dhe indikatorët e monitorimit.

- Monitorimi do të kryhet çdo vit përmes raporteve të dedikuara.
- Raportimi do të realizohet të paktën çdo gjashtë muaj.
- Rishikimi i planit parashikohet të bëhet periodikisht.

Plani i Integritetit 2025–2028 përbën një instrument kyç për modernizimin e administratës vendore. Këshilli Bashkiak luan një rol thelbësor për miratimin dhe mbështetjen politike të planit, për mbikëqyrjen e zbatimit të masave dhe për nxitjen e një kulture llogaridhënieje. Ky është një vendim i rëndësishëm politik dhe institucional që garanton që Bashkia Dibër të ecë drejt një administrate të ndershme, transparente dhe të besueshme.

Ridjon kafa





Bashkia Dibër

PLANI I INTEGRITETIT

2025-2028

Miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Diber nr

Të nderuar qytetarë, përfaqësues të institucioneve publike dhe partnere zhvillimi,

Me kënaqësi dhe ndjenjë përgjegjësie ju paraqes Planin e Integritetit dhe Antikorrupsionit të Bashkisë Dibër, një dokument strategjik që përbën themelin e angazhimit tonë për ndërtimin e një administrate të hapur, të ndershme dhe në shërbim të qytetarit.

Integriteti institucional dhe lufta kundër korrupsionit janë vlera thelbësore për ndërtimin e një qeverisjeje të mirë, të besueshme dhe të qëndrueshme. Për ne, si drejtues të njësisë vendore, transparenca, llogaridhënia dhe përfshirja qytetare nuk janë thjesht parime, por përbëjnë standarde të përditshme të punës sonë.

Ky Plan është rezultat i një procesi gjithëpërfshirës, të bazuar në konsultime me strukturat administrative, shoqërinë civile dhe aktorët lokalë, me synim identifikimin e pikave të dobëta dhe forcimin e mekanizmave të kontrollit dhe parandalimit. Ai përcakton objektiva të qarta, masa konkrete dhe një kalendar veprimesh që synojnë krijimin e një mjedisi institucional rezistent ndaj korrupsionit dhe abuzimeve.

Bashkia Dibër është e vendosur të ndërtojë institucione më të forta, të afta të shërbejnë me ndershmëri dhe profesionalizëm. Me këtë plan, ne forcojmë përkushtimin tonë për të qenë një administratë që i shërben qytetarit me dinjitet dhe etikë të lartë.

Ftoj çdo qytetar, punonjës të administratës dhe partner institucional që të bëhen pjesë aktive e zbatimit të këtij plani. *Vetëm përmes përpjekjeve të përbashkëta mund të ndërtojmë një shoqëri më të drejtë dhe një qeverisje vendore më të ndershme.*

Me respekt,

Rrahim Spahiu

Kryetar i Bashkisë Dibër

Lista e Akronimeve

Akronimi	Përshkrimi
-----------------	-------------------

GPI	Grupi i punes per Integritetin
-----	--------------------------------

PI	Plani i Integritetit
----	----------------------

AB	Audit I Brendshem
----	-------------------

BNJ	Burime Njerezore
-----	------------------

GMS.	Grupi I menaxhimit Strategjik
------	-------------------------------

GBP	Grant i bazuar ne Performance
-----	-------------------------------

ILDLPI	Inspektoriati I larte I deklarimit dhe kontrollit te pasurise dhe konfliktit te interesit
--------	---

AKKAgjencia Kundër Korrupsionit

AMVV Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore

EU Bashkimi Evropian

KLSH Kontrolli i Lartë i Shtetit

OGP Open Government Partnership (Partneriteti për Qeveri të Hapur)

OSHC Organizata e Shoqërisë Civile

QMK Qendra për Monitorimin e Korrupsionit

Hyrje në Planin e Integritetit të Bashkisë Dibër

Në një periudhë sfiduese për institucionet publike dhe qeverisjen vendore, ndërtimi i integritetit institucional, forcimi i transparencës dhe zbatimi i standardeve të larta etike janë më të domosdoshme se kurrë. Përballë pritshmërive gjithnjë në rritje të qytetarëve për shërbime efikase dhe një administratë të ndershme, Bashkia Dibër është e angazhuar fuqimisht në hartimin dhe zbatimin e Planit të Integritetit dhe Antikorrupsionit(2025-2028), si një instrument kyç për parandalimin e abuzimeve me pushtetin, rritjen e llogaridhënies dhe kultivimin e një kulture institucionale të ndershmërisë dhe profesionalizmit.

Ky dokument është hartuar në përputhje me kornizat ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare për integritetin publik, duke u bazuar në Ligjin nr. 60/2016 'Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve', Strategjinë Kombëtare Kundër Korrupsionit, si dhe në dokumentet udhëzuese të Ministrisë së Brendshme dhe institucioneve partnere. Plani gjithashtu merr në konsideratë përvojat më të mira të qeverisjes vendore dhe angazhimet e Shqipërisë në kuadër të Open Government Partnership, procesit të integritetit në Bashkimin Evropian dhe nismave të tjera ndërkombëtare për integritet dhe qeverisje të mirë.

Bashkia Dibër është një njësi e rëndësishme e qeverisjes vendore që mbulon një territor të gjerë dhe një popullsi të shpërndarë në zona urbane dhe rurale. Sfida të tilla si kapacitetet administrative të kufizuara, burimet e pamjaftueshme njerëzore dhe ekonomike, përfshirja e ulët e qytetarëve në vendimmarrje dhe perceptimet për mungesë transparence në disa sektorë, e bëjnë të domosdoshme ndërtimin e një strukture të qëndrueshme për integritetin institucional.

Qëllimi kryesor i këtij Plani është forcimi i kapaciteteve institucionale të Bashkisë Dibër për të parandaluar, identifikuar dhe adresuar fenomenet e korrupsionit, konfliktit të

interesit, keqmenaxhimit dhe mungesës së llogaridhënies. Plani parashikon objektiva specifike si: hartimi dhe zbatimi i mekanizmave të brendshëm për kontrollin dhe auditimin e veprimeve administrative; rritja e transparencës në proceset e vendimmarrjes, prokurimeve publike dhe menaxhimit të burimeve njerëzore; ndërgjegjësimi dhe formimi i stafit mbi normat etike; ngritja e mekanizmave për përfshirjen e qytetarëve në monitorim; dhe promovimi i një klime zero tolerancë ndaj korrupsionit.

Plani është hartuar përmes një procesi gjithëpërfshirës që ka përfshirë analizën e kontekstit aktual institucional dhe ligjor; vlerësimin e riskut për korrupsion në funksione dhe procese të ndryshme të administratës; konsultimin me drejtuesit e njësive administrative, stafin e Bashkisë, këshillin bashkiak dhe përfaqësues të komunitetit; si dhe referencën me modelet dhe praktikatat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.

Nëpërmjet këtij dokumenti, Bashkia Dibër synon të dërgojë një mesazh të qartë për vendosmërinë ndaj ndërtimit të një administrate të ndershme dhe me integritet. Ky plan është një thirrje për bashkëpunim me qytetarët, shoqërinë civile, biznesin dhe institucionet e tjera publike, në mënyrë që së bashku të ndërtojmë një të ardhme më të ndershme dhe më të drejtë për të gjithë.

Procesi i Zhvillimit të Planit të Integritetit

Zhvillimi i Planit të Integritetit të Bashkisë Dibër është mbështetur në një proces të strukturuar, të bazuar në metodologjinë kombëtare të vlerësimit të riskut për integritet në njësitë e qeverisjes vendore. Ky proces është orientuar drejt identifikimit të zonave më të ekspozuara ndaj rrezikut të korrupsionit, konfliktit të interesit dhe praktikave që bien ndesh me parimet e qeverisjes së mirë.

Procesi është udhëhequr nga një grup pune i ngritur brenda Bashkisë.

Në fazën e parë janë analizuar funksionet dhe strukturat ekzistuese të administratës bashkiake. Janë zhvilluar takime me përfaqësues të drejtorive, përfaqësues të Këshillit

Bashkiak dhe stafit teknik, për të identifikuar zonat më kritike për integritetin institucional.

Metodologjia e përdorur për vlerësimin e riskut është ajo e miratuar nga Ministria e Brendshme dhe AMVV, e cila fokusohet në disa fusha kryesore të funksionimit të njësive të qeverisjes vendore. Për secilën fushë janë zhvilluar pyetësorë, intervista të strukturuar dhe janë analizuar dokumente dhe praktika të brendshme administrative.

Fushat ku është përqendruar vlerësimi i riskut për integritet janë si më poshtë:

1. Planifikimi strategjik dhe vendimmarrja;
2. Hartimi dhe zbatimi i buxhetit;
3. Prokurimet publike;
4. Menaxhimi i burimeve njerëzore;
5. Dhënia e lejeve;
6. Shërbimet publike dhe ndërveprimi me qytetarët;
7. Menaxhimi i pronës publike dhe pasurive të paluajtshme;
8. Transparenca dhe komunikimi me publikun;
9. Mekanizmat e kontrollit të brendshëm dhe auditimi;
10. Parandalimi dhe menaxhimi i konfliktit të interesit dhe sinjalizimi i korrupsionit.

Për secilën nga këto fusha, grupi i punës ka analizuar rregulloret, praktikat administrative, kapacitetet njerëzore, dokumentacionin e brendshëm si dhe praktikat e raportimit dhe mbikëqyrjes. Në bazë të kësaj analize është ndërtuar një hartë risku, që identifikon fushat me nivel të lartë, të mesëm dhe të ulët të rrezikut për korrupsion ose sjellje të papërshtatshme.

Procesi është zhvilluar me transparencë dhe përfshirje, duke organizuar fokus-grupe dhe konsultime me qytetarë, përfaqësues të shoqërisë civile dhe aktorë të tjerë lokalë. Ky angazhim ka ndihmuar jo vetëm në identifikimin e problematikave aktuale, por edhe në krijimin e një baze për masa konkrete parandaluese që janë të pranueshme dhe realisht të zbatueshme nga administrata vendore.

Për çdo fushë është propozuar një paketë masash që përfshijnë përmirësime në legjislacionin e brendshëm të Bashkisë, trajnime për personelin, fuqizim të mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe përmirësim të teknologjise për transparencë. Këto masa janë përfshirë më tej në planin e veprimit dhe janë prioritarizuar sipas nivelit të riskut dhe rëndësisë për administratën dhe qytetarët.

Në përfundim të procesit të vlerësimit, Bashkia Dibër ka përfituar një kuptim më të qartë të sfidave të saj në drejtim të integritetit institucional. Ky proces ka shërbyer si themel për ndërtimin e një plani realist dhe të zbatueshëm, i cili nuk përmban thjesht masa teorike, por ndërhyrje të matshme, afate të percaktuara, dhe me burime të identifikuara.

Zhvillimi i këtij procesi përbën një hap të rëndësishëm drejt ndërtimit të një administrate më të përgjegjshme, më efikase dhe më të ndershme, duke forcuar kështu besimin e qytetarëve ndaj institucioneve vendore.

Permbajtja e Planit të Integritetit – Bashkia Diber

Plani i Integritetit i Bashkisë Diber paraqet një qasje të strukturuar dhe të gjithanshme për forcimin e etikës institucionale, parandalimin e korrupsionit dhe rritjen e llogaridhënies në nivel vendor. Dokumenti është ndarë në disa seksione kryesore që pasqyrojnë analizën e kontekstit vendor, vlerësimin e riskut për integritet në funksione të ndryshme të administratës dhe përcaktimin e objektivave strategjike.

Në thelb, plani fokusohet në tri shtylla kryesore: përmirësimin e kornizës institucionale, forcimin e mekanizmave të kontrollit dhe monitorimit, si dhe rritjen e besimit të qytetarëve ndaj institucioneve vendore. Çdo objektiv shoqërohet me masa të detajuara, indikatorë monitorimi dhe afate kohore për zbatim.

Gjithashtu, plani përfshin një vlerësim të detajuar të riskut për integritet në disa fusha prioritare të qeverisjes vendore, si: prokurimet, burimet njerëzore, menaxhimi i pronës publike, shërbimet administrative etj. Në fund, dokumenti parashikon mekanizma konkretë për ndjekjen dhe raportimin e zbatimit, duke siguruar që plani të mos mbetet thjesht një angazhim në letër, por një mjet i gjallë për qeverisje të ndershme dhe efikase.

Prezantim i Përgjithshëm i Kontekstit Vendor dhe Prioritetet e Zhvillimit të Bashkisë Dibër

Bashkia Dibër, e pozicionuar në verilindje të Shqipërisë, është një nga njësitë territoriale më të mëdha në vend për nga sipërfaqja dhe sfidat gjeografike. E krijuar si rezultat i reformës administrative-territoriale të vitit 2015, ajo përfshin 15 njësi administrative dhe ka për qendër qytetin e Peshkopisë. Me një sipërfaqe prej afro 1001 km² dhe një popullsi prej rreth 50.775 banorësh, (Census 2023) Bashkia Dibër përfaqëson një bashkësi të përbërë nga fshatra të thella malore (141) zona të banuara urbane dhe komunitete me burime të kufizuara.

Karakteri kryesisht rural dhe gjeografia e thyer malore ndikojnë drejtpërdrejt në aksesin dhe ofrimin e shërbimeve publike për qytetarët. Mungesa e infrastrukturës rrugore të zhvilluar, lëvizshmëria e kufizuar, emigracioni dhe plakja e popullsisë janë elementë që ndikojnë në planifikimin dhe zbatimin e politikave vendore. Në aspektin ekonomik, aktivitetet bujqësore dhe blegtorale përbëjnë bazën kryesore të të ardhurave për pjesën më të madhe të popullsisë, ndërsa niveli i formalizimit të ekonomisë mbetet i ulët.

Administrata vendore e Bashkisë Dibër përballlet me sfida të vazhdueshme në drejtim të burimeve njerëzore, buxhetit të kufizuar, përdorimit të teknologjisë dhe angazhimit qytetar. Megjithatë, janë evidentuar përpjekje pozitive për modernizimin e shërbimeve, forcimin e mekanizmave të transparencës dhe përmirësimin e funksionimit të strukturave të brendshme administrative. Pjesëmarrja e Bashkisë në programe zhvillimi dhe projekte të bashkëpunimit ndërkombëtar ka kontribuar në rritjen e kapaciteteve dhe inovacionit në nivel lokal.

Bazuar në analizën e nevojave dhe burimeve, Bashkia Dibër ka identifikuar një sërë prioritetesh zhvillimore që përbëjnë boshtin strategjik të ndërhyrjeve të saj në vitet në vijim. Këto prioritete përfshijnë:

1. “Zhvillimi i infrastrukturës dhe përmirësimi i aksesit” – Investime në rrugë rurale, ujësjellës, kanalizime dhe infrastrukturë urbane për të garantuar akses të barabartë në të gjitha zonat e Bashkisë.
2. “Modernizimi i shërbimeve publike dhe digjitalizimi” – Zbatimi i platformave dixhitale për ofrimin e shërbimeve administrative dhe forcimi i kapaciteteve institucionale për një administratë më efikase dhe transparente.
3. “Zhvillimi ekonomik lokal dhe bujqësor” – Mbështetje për fermerët, formalizimi i ekonomisë rurale, krijimi i tregjeve lokale dhe promovimi i produkteve vendore.
4. “Fuqizimi i kapitalit njerëzor dhe arsimit” – Investime në infrastrukturën arsimore dhe ngritje të cilësisë së arsimit profesional dhe trajnimeve për të rinjtë.
5. “Mbrojtja e mjedisit dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore” – Rritja e ndërgjegjësimit dhe ndërhyrje konkrete për mbrojtjen e pyjeve, lumenjve dhe zonave të mbrojtura, duke mbështetur një zhvillim të qëndrueshëm.
6. “Rritja e përfshirjes qytetare dhe forcimi i besimit në institucionet publike” – Ngritja e mekanizmave për pjesëmarrje efektive të qytetarëve në proceset vendimmarrëse dhe zbatimin e politikave të hapura për të gjithë.

Në këtë kuadër, Plani i Integritetit vjen si një element kyç për të siguruar që këto prioritetë të zbatohen mbi baza të qarta etike, me integritet institucional dhe në përputhje me standardet e një qeverisjeje të mirë.

Procesi i Zhvillimit të Planit të Integritetit Bashkia Diber

Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit në Bashkinë Diber përfshin disa faza të rëndësishme, të cilat janë të lidhura me analizën dhe implementimin e masave që

mundësojnë përmirësimin e transparencës dhe luftimin e korrupsionit. Ja një përmbledhje e fazave të hartimit:

1. Vlerësimi i Situatës Aktuale

Faza e parë e zhvillimit të Planit të Integritetit është **vlerësimi i situatës aktuale**, i cili përfshin analizën e rrezikut të korrupsionit dhe mbledhjen e të dhënave për të kuptuar më mirë se ku ndodhen dobësitë dhe risqet në administratën publike. Ky proces kërkon një vlerësim të thelluar të aktiviteteve administrative dhe shërbimeve publike që ofrohen nga Bashkia Dibër. Analiza fokusohet në identifikimin e sektorëve dhe procedurave që janë më të ndjeshëm ndaj korrupsionit, si dhe në shkeljet e mundshme të etikës dhe legjislacionit. Gjatë kësaj faze, do të përdoren metoda si intervistat me stafin dhe qytetarët, sondazhe të brendshme dhe analiza të raporteve të mëparshme të auditimit për të kuptuar pasqyrën e përgjithshme të administratës publike.

Analiza e riskut: Kjo fazë përfshin analizën e niveleve të ndryshme të rrezikut të korrupsionit në nivele të ndryshme të administratës publike dhe identifikimin e sektorëve më të cenueshëm.

Mbledhja e të dhënave: Mbledhja e informacionit nga burime të ndryshme, si dhe anketat ose intervistat me stafin dhe qytetarët për të kuptuar më mirë sfidat dhe dobësitë ekzistuese. Në këtë fazë është shpërndarë një pyetësor elektronik anonim me gjithë stafin e bashkisë dhe keshillin bashkiak me qëllim për të siguruar të dhëna për vlerësimin e sistemit të integritetit.

Bazuar në të dhënat e mbledhura nga pyetësi me stafin, gjetjet janë si vijon: Nga përgjigjet e 52 pjesëmarrësve, shumica e të anketuarve kanë përvojë mbi 4 vite në administratën publike. 50% e tyre kanë mbi 4–10 vite eksperiencë, ndërsa 22% mbi 10 vite. Kjo tregon një bazë solide të stafit me përvojë të konsiderueshme, megjithatë ekziston edhe një pjesë (rreth 17%) me më pak se 1 vit përvojë, që nënkupton nevojën për mentorim dhe integrim më të mirë të punonjësve të rinj.

Sa i perket transparences, publikimi i akteve vendimmarrëse shihet pozitivisht nga 88.2% e të anketuarve, ndërsa 11.8% thonë të kundërtën. Gjithashtu mbi 80% mendojnë se informacioni mbi vendimmarrjet është i qasshëm për qytetarët. Këto rezultate tregojnë një nivel relativisht të mirë transparence, por mbetet nevoja për përmirësim të përfshirjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

Kodi i Etikës njihet plotësisht nga 76.5% e stafit, pjesërisht nga 23.5%, ndërsa askush nuk e mohon ekzistencën e tij. 94.1% i konsiderojnë proceset e brendshme të qarta dhe të ndershme. Megjithatë, vetëm 71.4% kanë marrë trajnim mbi etikën, çka nënkupton domosdoshmërinë e investimit më të madh në formimin etik të stafit.

Vetëm 41.2% pohojnë se ekziston një mekanizëm sinjalizimi, ndërsa 58.8% nuk e dinë. 41.2% mendojnë se sinjalizuesit trajtohen me mbrojtje, por pjesa tjetër mbetet e pasigurt. Sa i perket sigurisë për të raportuar, vetëm 52.9% ndihen të sigurt, ndërsa 47.1% jo.

Asnjë nuk raportoi presion të drejtpërdrejtë, por 17.6% pranuan se ndonjëherë kanë ndjerë presion. Vetëm 1 punonjës ka hasur konflikt interesi, ndërsa 94% jo. Gjithsesi, 82.4% deklarojnë se dinë si të raportojnë konfliktin e interesit, duke treguar progres në ndërgjegjësim.

82.4% pranojnë se kanë dijeni ose kanë dëgjuar raste korrupsioni. Asnjë nuk konfirmoi ekzistencën e një mekanizmi funksional raportimi. Sektorët më të rrezikuar sipas perceptimit janë: përdorimi i fondeve publike (35%), prokurimet publike (12%), proceset e lejeve (12%) dhe burimet njerëzore (6%).

Punonjësit sugjerojnë: përmirësimin e rregullores, kodit etikes sa i perket sinjalizimit, njesise perkatese, krijimin e hapësirave publike për konsultim, si dhe fuqizimin e mekanizmave të raportimit dhe trajnimeve mbi integritetin.

2. Formulimi i Objektivave Strategjike

Pasi të jenë grumbulluar të dhënat dhe të jenë identifikuar rreziqet kryesore, faza e dytë përfshin formulimin e objektivave strategjikë. Ky hap ka për qëllim të përcaktojë qëllimet që duhen arritur për të përmirësuar integritetin dhe transparencën në administratën lokale. Objektivat mund të përfshijnë përmirësimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm, forcimin e transparencës në proceset e vendimmarrjes, si dhe rritjen e përgjegjshmërisë dhe besueshmërisë tek qytetarët. Për secilin objektiv, duhet të identifikohen masa konkrete të veprimit dhe aktivitete të nevojshme për t'i arritur këto qëllime. Objektivat duhet të jenë të matshëm dhe të lidhur ngushtësisht me nevojat e identifikuara gjatë vlerësimit të situatës.

Përcaktimi i qëllimeve: Përcaktimi i objektivave të qarta për përmirësimin e integritetit në administratën lokale, përfshirë përmirësimin e transparencës, mekanizmave të kontrollit dhe pjesëmarrjes publike.

Definimi i masave të veprimit: Krijimi i masave të veprimit që adresojnë çdo aspekt të identifikuar si me risk të lartë.

3. Përgatitja e Planit të Veprimit

Faza e tretë e zhvillimit të Planit të Integritetit është **përgatitja e planit të veprimit**. Ky dokument do të përfshijë një përshkrim të detajuar të aktiviteteve që do të ndërmerren për të realizuar objektivat strategjikë të përcaktuar më parë. Plani i veprimit duhet të përfshijë afatet kohore për implementimin, burimet financiare dhe njerëzore që do të kërkohen, si dhe përgjegjësitë e individëve dhe grupeve të caktuar për realizimin e aktiviteteve. Gjatë këtij procesi, prioritetet për implementimin duhet të merren parasysh, duke identifikuar cilat aktivitete janë më urgjente dhe cilat mund të zbatohen në faza më të vonshme.

Korniza e veprimit: Definimi i një plani të detajuar për implementimin e masave të propozuara, përfshirë afatet kohore, burimet e nevojshme dhe përgjegjësitë përkatëse.

Prioritizimi i aktiviteteve: Vendosja e prioriteteve për implementimin e masave, duke pasur parasysh burimet dhe mundësitë e Bashkisë Dibër.

4. Pjesëmarrja e Palëve të Interesit

Në fazën e katërt, është shumë e rëndësishme të përfshihen të gjithë palët e interesuara, përfshirë qytetarët, organizatat e shoqërisë civile, dhe aktorë të tjerë që mund të kontribuojnë në forcimin e procesit. Pjesëmarrja e këtyre grupeve është e nevojshme për të siguruar që plani i integritetit të jetë i pranueshëm dhe të përfaqësojë interesat e të gjithë palëve. Organizimi i konsultimeve publike nga Keshilli Bashkiak dhe diskutimeve me aktorët relevantë është një hap i domosdoshëm për të mbledhur feedback dhe sugjerime që mund të përmirësojnë projektin e planit. Kjo gjithashtu siguron një mbështetje më të gjerë për implementimin e tij dhe nxit angazhimin e qytetarëve dhe grupeve të interesuara për të monitoruar progresin.

Konsultimi me palët e interesuara: Organizimi i konsultimeve me qytetarët, grupe të interesit, dhe aktorë të tjerë relevantë për të siguruar mbështetje dhe përmirësime në proces.

Përfshirja e shoqërisë civile dhe institucioneve të tjera: Pjesëmarrja e grupeve të shoqërisë civile dhe organizatave ndërkombëtare që mund të kontribuojnë në vlerësimin dhe mbikëqyrjen e procesit.

5. Implementimi dhe Monitorimi

Implementimi dhe monitorimi janë faza të cilat ndihmojnë në realizimin e aktiviteteve të përcaktuara në planin e veprimit. Gjatë implementimit, është e rëndësishme që të merren masat e duhura për të siguruar se çdo aktivitet do të realizohet në përputhje me afatet dhe burimet e caktuara. Po ashtu, kjo fazë përfshin krijimin e mekanizmave të monitorimit dhe mbikëqyrjes, të cilët mund të përfshijnë auditime të brendshme dhe të jashtme për të vlerësuar ecurinë e zbatimit të planit. Raportimi i rregullt dhe analiza e përparimit janë të

domosdoshme për të identifikuar çdo devijim nga plani dhe për të marrë masa korigjuese, nëse është e nevojshme.

Vigjilenca e zbatimit: Implementimi i masave dhe strategjive të përcaktuara në planin e veprimit, duke monitoruar përparimin dhe përputhshmërinë me objektivat e vendosura.

Krijimi i mekanizmave të monitorimit dhe vlerësimit: Vendosja e sistemeve të vlerësimit dhe monitorimit për të siguruar që plani i integritetit të zbatohet në mënyrë efektive dhe të qëndrueshme.

6. Raportimi dhe Rishikimi i Planit

Për të siguruar që plani i integritetit të jetë dinamik dhe i përshtatshëm për çdo ndryshim në mjedisin administrativ dhe ligjor, është e nevojshme që plani të raportohet dhe rishikohet në mënyrë periodike. Raportimi duhet të paraqesë progresin e arritur dhe të identifikojë çdo pengesë ose sfidë që ka dalë gjatë implementimit. Rishikimi i planit duhet të bëhet në një periudhë të rregullt, për shembull çdo vit, për të siguruar që ai mbetet i përshtatshëm dhe i efektshëm. Rishikimi mund të përfshijë sugjerime për përmirësime dhe mund të pasqyrojë rezultatet e analizave të reja të situatës dhe të dhënave.

Raportimi i përparimit: Përcaktimi i mekanizmave të raportimit të përparimit dhe përshtatshmërisë së masave të zbatuara.

Rishikimi periodik: Rishikimi i planit në mënyrë të rregullt dhe përshtatja e tij në varësi të rezultateve dhe ndryshimeve në ambientin e punës.

7. Përmirësimi i Kontabilitetit dhe Transparencës

Në fazën e fundit të zhvillimit të Planit të Integritetit, përmirësimi i kontabilitetit dhe transparencës është një hap kyç për të siguruar besueshmërinë e administratës publike. Forcimi i mekanizmave të kontrollit, si auditimi dhe monitorimi i brendshëm, ndihmon

në parandalimin e korrupsionit dhe rrit transparencën e proceseve. Po ashtu, duke përdorur teknologjinë dhe sistemet e informacionit, mund të krijohen mundësi për qytetarët dhe aktorët e tjerë të kenë një akses më të lehtë dhe të drejtpërdrejtë në informacionet publike dhe proceset vendimmarrëse. Ky hap siguron që administrata të jetë e hapur ndaj verifikimit dhe vlerësimit nga qytetarët dhe palët e tjera të interesuara, duke rritur besimin e tyre në institucionet publike.

Forcimi i mekanizmave të kontrollit: Rritja e mekanizmave të brendshëm të kontrollit, përfshirë auditimin dhe verifikimin e aktiviteteve administrative.

Përmirësimi i qasjes së qytetarëve: Përdorimi i teknologjisë për të rritur transparencën dhe përfshirjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

Objektivi Strategjik 1: Forcimi i Kuadrit të Brendshëm Rregullator në Aspekte të Vecanta të Etikës dhe Integritetit me qëllim funksionimin efektiv të menaxhimit të riskut, dhe përmirësimin e performances.

Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator përfshin përmirësimin e politikave dhe procedurave që ndihmojnë në ruajtjen e integritetit dhe etikës në administratën publike. Ky proces është i domosdoshëm për të siguruar që të gjitha veprimet dhe vendimet e Bashkisë Dibër të bazohen në parime të qarta dhe të drejta, dhe për të parandaluar çdo mundësi për korrupsion, abuzim ose keqtrajtim të resurseve publike. Në këtë kuadër, do të krijohet një sistem rregullator që do të përcaktojë jo vetëm politikat e etikës dhe integritetit, por edhe mekanizmat e mbikëqyrjes, monitorimit dhe vlerësimit të këtyre politikave, duke siguruar që ato të respektohen në çdo nivel të administratës.

Objektivat specifike:

Objektivi specifik 1: Përmirësimi i Politikave të Etikës dhe Integritetit

Forcimi i politikave të etikës dhe integritetit do të përfshijë zhvillimin e një kodi të etikës dhe Rregullores të brendshme në përputhje me parimet e integritetit, që përcaktojnë standardet e sjelljes për të gjithë punonjësit e Bashkisë Dibër.

Ky kod do të mbulojë aspekte të rëndësishme si:

Parimet e integritetit dhe transparencës: Përcaktimi i parimeve që drejtojnë të gjitha aktivitetet administrative dhe vendimmarrëse. Lufta kundër korrupsionit: Mënyra se si të identifikohen, parandalohen dhe veprohet në lidhje me situatat e korrupsionit. Raportimi i shkeljeve etike: Krijimi i një mekanizmi të sigurt dhe anonim për raportimin e shkeljeve etike dhe abuzimeve të mundshme. Përgjegjësitë e Drejtoreve, Përgjegjesve dhe punonjësve: Definimi i përgjegjësiave për çdo nivel të administratës dhe roli i udhëheqësve për të mbajtur standardet etike të Bashkisë. Përkufizimin e parimeve të etikës që duhet të ndjekin punonjësit e Bashkisë, përfshirë drejtësinë, transparencën dhe respektin për ligjin. Politikat e raportimit të shkeljeve etike dhe ndihmën që ofrohet për sinjalizuesit e korrupsionit dhe shkeljeve të tjera. Trajnimin e stafit mbi kodin e etikës dhe rregullat e brendshme për të siguruar që të gjithë janë të njohur me këto politika dhe të angazhohen në zbatimin e tyre.

Objektivi Specifik 2: Zhvillimi i Trajnimeve për Stafin në Fushën e Integritetit dhe Etikës

Për të siguruar që politika dhe strategjitë për integritetin të implementohen me sukses, një objektivi specifik është zhvillimi i trajnimeve të vazhdueshme për stafin lidhur me etikën dhe integritetin. Ky objektivi do të përfshijë:

Programi i trajnimit për etikën dhe integritetin: Krijimi i një programi trajnimi të detajuar që do të fokusohet në rëndësinë e etikës dhe integritetit në administratën publike, duke përfshirë tema të tilla si korrupsioni, transparenca, dhe menaxhimi i burimeve.

Trajnimi i Drejtoreve dhe Përgjegjesve: Sigurimi që pozicionet drejtuese të jenë të trajnuar dhe të pajisur me njohuri dhe aftësi për të implementuar politikën e integritetit dhe për të siguruar respektimin e standardeve etike.

Objektivi Specifik 3: Rritja e Transparencës dhe Publikimi i Informacioneve të Rëndësishme për Qytetarët

Një objektiv tjetër i rëndësishëm është rritja e transparencës dhe publikimi i informacionit të rëndësishëm për qytetarët, i cili do të ndihmojë në krijimin e një administrate të hapur dhe të besueshme. Ky objektiv përfshin:

Publikimi i të dhënave të qarta dhe të sakta: Sigurimi që informacioni i rëndësishëm, siç janë proceset e tenderëve, shpenzimet publike, dhe vendimmarrjet, të jenë të disponueshëm për qytetarët nëpërmjet platformave publike.

Përmirësimi i komunikimit me qytetarët: Krijimi i mundësive për qytetarët që të kenë një akses të lehtë dhe të drejtpërdrejtë në informacionet që i prekin ata.

Angazhimi i shoqërisë civile dhe grupimeve të interesit: Sigurimi që palët e interesuara të jenë të përfshira në procesin e transparencës dhe që ato të kenë mundësi të japin mendime dhe të kontribuojnë në përmirësimin e performancës.

Objektivi Specifik 4: Krijimi i Mjedisit të Menaxhimit të Performancës Institucionale

Treguesit e performancës janë një mjet i rëndësishëm për Ministrinë e Financave për të monitoruar dhe vlerësuar performancën e bashkive në Shqipëri. Në këtë aspekt ***Njesia e Performances se krijuar në Bashkinë Diber*** do të monitorojë në identifikimin e fushave ku mund të përmirësohet efikasiteti dhe ofrimi i shërbimeve, duke siguruar që fondet publike përdoren në mënyrë të qëndrueshme dhe në përputhje me parimet e transparencës dhe llogaridhënies. Rëndësia e këtyre treguesve është thelbësore për të siguruar një menaxhim të suksesshëm dhe të përgjegjshëm të financave publike në nivelin lokal. Nisur dhe nga zhvillimet e fundit të Grantit të Bazuar në Performancë (GBP) iniciuar nga Ministria e Financave dhe Ambasada e Zvicrës dhe Suedisë nëpërmjet Projektit Bashki të Forta, puna e Bashkisë do të intensifikohet me qëllim përmirësimin e pikezimit të Bashkisë në nivel kombëtar, si dhe përthithjen e sa më shumë fondeve nga ky grant.

Një tjetër objektiv është krijimi i një mjedisi të menaxhimit të performances institucionale, për të siguruar që Bashkia Diber të arrijë objektivat e saj dhe të përmirësojë vazhdimisht shërbimet që ofron. Ky objektiv do të përfshijë:

Vendosja e sistemit të vlerësimit të performancës: Krijimi i mekanizmave për matjen e performancës së secilit departament dhe punonjës, duke përdorur indikatorë të qartë dhe të matshëm. Inkurajimi i përmirësimit të vazhdueshëm: Krijimi i një kulture që inkurajon përmirësimin e vazhdueshëm dhe që stimulohet nga rezultatet e performancës. Raportimi i rezultateve dhe angazhimi i qytetarëve: Sigurimi që qytetarët dhe grupet e interesit të kenë informacion të rregullt mbi arritjet dhe sfidat e Bashkisë, duke u siguruar që administrata të jetë përgjegjëse për rezultatet e saj.

Objekivi Strategjik II: Përmirësimi i Procedurave të kontrollit dhe monitorimit; Forcimi i Integritetit në Proceset dhe Fushat Funktionale të Bashkisë Diber dhe Kapaciteteve Institucionale për të Mirëmbajtur dhe Konsoliduar Mekanizmat

Ky objektiv strategjik ka për qëllim përmirësimin e integritetit të administratës së Bashkisë Diber dhe rritjen e kapaciteteve institucionale për të menaxhuar dhe konsoliduar mekanizmat që mbështesin proceset dhe fushat funksionale të bashkisë Diber. Në këtë kuadër, synohet forcimi i transparencës, përmirësimi i cilësisë së shërbimeve dhe garantimi i një mjedisi të besueshëm për qytetarët dhe aktorët e tjerë të interesuar. Ky objektiv mund të zbërthehet në disa objektiva specifike që lidhen me forcimin e integritetit dhe kapaciteteve institucionale.

Objektiva Specifike:

Objektivi Specifik 1: Forcimi i Transparencës dhe Integritetit në Proceset e Vendimmarrjes dhe Prokurimeve, menaxhimit financiar, burimeve njerezore, menaxhimit te pronave publike, sherbimeve publike, dhe dokumentacionit.

Një aspekt i rëndësishëm për forcimin e integritetit është përmirësimi i procesit të vendimmarrjes dhe prokurimeve, duke siguruar që të gjitha aktivitetet të jenë të hapura, të drejta dhe të bazuara në ligj, duke filluar nga përparimet dhe miratimi i regjistrit për parashikimet e prokurimeve publike, ofertat, kushtet, dokumentet origjinale dhe arkivimi i tyre si dhe të aplikohet rotacion në ngritjen e KVO, Komisioni i ankesave etj.

Për fushën e pronave publike synohet një sistem për administrimin e pronave, së fundmi shumë i nevojshëm edhe në kuadër të Paketës së Maleve.

Për burimet njerezore synohet hartimi i manualit të proceseve të punës për të gjitha funksionet, dhe pozicionet, me detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara, si dhe ngritja e sistemit të vlerësimit të performancës së stafit bazuar në abshkëpunim të ngushtë me njesinë e performancës, për realizimin e objektivave të zyres përkatëse në ofrimin e sherbimeve bazuar në performancë.

Sa i përket arkivimit të dokumenteve synohet hartimi i një rregulloreje për proceset e administrimit të dokumenteve arkivore në Bashkinë Diber bazuar në ligjin për arkivat, , ku të përcaktohen standartet, formatet, procedurat, afatet etj, si dhe ngritja e arkives digjitale.

Sa i përket sherbimeve publike Bashkia Diber synon miratimin e rregullorejeve që përcakton standartin lokal të bashkisë Diber për cilësinë e sherbimeve (ligji përcakton standartin minimal), si dhe trajnime për stafin. Llogaridhënie mbi bazë treguesish performancë ndaj keshillit Bashkiak por edhe raporte periodike ndaj qytetarëve për sherbimet, cilësinë, analizen kosto përfitim etj.

Objektivi Specifik 2: Përforsimi i Kapaciteteve të Stafit të Bashkisë në Fushat e Etikës dhe Integritetit

Një tjetër objektivi është përmirësimi i kapaciteteve të stafit të bashkisë për të zbatuar praktikën më të mirë të integritetit dhe etikës në menaxhimin e aktiviteteve të përditshme dhe në ofrimin e shërbimeve publike.

Trajnimi i vazhdueshëm i stafit si dhe edukimi mbi standartet etike: Ofrimi i trajnimeve të rregullta për menaxhimin e etikës dhe integritetit për të gjithë punonjësit e administratës lokale. Krijimi i një programi edukimi që do të njohë stafin me parimet e etikës dhe integritetit dhe me rëndësinë e këtyre parimeve në administratën publike.

Objektivi Specifik 3: Konsolidimi i Mekanizmave të Kontrollit dhe Monitorimit të Performancës Institucionale

Një tjetër hap i rëndësishëm është forcimi i mekanizmave të kontrollit dhe monitorimit të performancës institucionale, për të siguruar që politikat dhe strategjitë për integritetin të zbatohen dhe të mbahen në një nivel të lartë.

Monitorimi i proceseve dhe aktiviteteve: Krijimi i mekanizmave të fortë për monitorimin e proceseve të brendshme të administratës dhe të performancës së stafit, duke siguruar që ato janë në përputhje me standartet e integritetit dhe etikës.

Objektivi Specifik 4: Përmirësimi i Infrastrukturës Institucionale për Menaxhimin e Riskut të Integritetit

Për të përmirësuar menaxhimin e riskut të integritetit, Bashkia Diber do krijojë dhe konsolidojnë infrastrukturën institucionale për menaxhimin e riskut të integritetit, duke përfshirë krijimin e strukture dhe sistemit për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve të mundshme.

Krijimi i një strukture të dedikuar për menaxhimin e riskut nepermjet vendosjes së një njësie ose ekipi të dedikuar për menaxhimin e riskut të integritetit që do të identifikojë dhe do të ndihmojë në adresimin e rreziqeve në çdo fushë të administratës.

Implementimi i një sistemi monitorimi të riskut nepermjet krijimit i një sistemi të monitorimit të rrezikut që siguron mbikëqyrjen e vazhdueshme dhe vlerësimin e efikasitetit të masave të marra për menaxhimin e riskut.

Objektivi Specifik 5: Angazhimi i Qytetarëve dhe Pjesëmarrësve të Tjerë në Proceset e Integritetit

Një aspekt i rëndësishëm për forcimin e integritetit është përfshirja aktive e qytetarëve dhe grupeve të interesuara në proceset që lidhen me integritetin dhe transparencën e administratës vendore. Konsultimi i qytetarëve dhe shoqërisë civile: Angazhimi i qytetarëve dhe grupeve të shoqërisë civile në hartimin dhe implementimin e politikave të integritetit dhe etikës për të siguruar se ato janë të pranueshme dhe efektive.

Pjesëmarrja në monitorimin e shërbimeve publike nepermjet Inkurajimit i qytetarëve të marrin pjesë në proceset e monitorimit dhe vlerësimit të shërbimeve që do të ofrohen nga bashkia Diber për të siguruar që ato janë të përshtatshme dhe efektive.

Kanale të hapura për raportimin e shkeljeve nepermjet mekanizmit anonim që qytetarët dhe palët e tjera të interesuara të kenë mundësi të raportojnë shkeljet e mundshme të etikës dhe integritetit në mënyrë të sigurt dhe anonime.

Objektivi strategjik III: Rritjen e besimit të qytetarëve ndaj Bashkisë Diber

Rritja e besimit të qytetarëve ndaj Bashkisë Diber përbën një nga shtyllat më të rëndësishme të ndërtimit të një administrate vendore të qëndrueshme, legjitime dhe të përgjegjshme. Besimi i qytetarëve nuk fitohet vetëm nëpërmjet premtimeve, por përmes veprimeve konkrete, transparencës së qëndrueshme, respektimit të ligjit dhe ofrimit të shërbimeve cilësore në mënyrë të barabartë për të gjithë. Në këtë drejtim, Bashkia Diber synon të përmirësojë ndjeshëm mënyrën se si komunikon dhe ndërvepron me

komunitetin, duke garantuar informim të drejtë dhe të rregullt, akses të lehtë në të dhënat publike, dhe përfshirje aktive të qytetarëve në proceset e vendimmarrjes.

Objektivi Specifik 1: Përmirësimi i transparencës dhe aksesit në informacion publik

Ky objektivi synon që Bashkia Dibër të garantojë një nivel më të lartë transparence institucionale, nëpërmjet publikimit të rregullt të vendimeve, buxheteve, tenderëve, kontratave dhe raportimeve të performancës. Qytetarët duhet të kenë mundësi të kenë akses të lehtë dhe të qartë në informacionet që i prekin drejtpërdrejt, nëpërmjet kanaleve digjitale, tabelave informuese apo konsultimeve të hapura. Ky proces përforcon llogaridhënien e administratës dhe redukton perceptimet për mungesë transparence apo abuzime.

Objektivi Specifik 2: Fuqizimi i pjesëmarrjes qytetare në proceset e vendimmarrjes

Besimi i qytetarëve rritet kur ata ndihen të dëgjuar dhe të përfshirë. Ky objektivi përqendrohet në rritjen e mundësive për qytetarët që të marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes përmes forumeve publike, konsultimeve për politika dhe projekte lokale, buxhetimit pjesëmarrës, dhe përdorimit të mekanizmave për dhënien e feedback-ut. Përdorimi i teknologjisë nëpërmjet konsultimeve online rrit gjithëpërfshirjen edhe në mungesë të kohës apo pjesëmarrjes fizike. Në këtë mënyrë, vendimmarrja bëhet më gjithëpërfshirëse dhe më legjitime.

Objektivi Specifik 3: Rritja e cilësisë dhe llogaridhënies në ofrimin e shërbimeve publike

Ky objektivi synon të përmirësojë standardin e shërbimeve që ofron bashkia, nëpërmjet vendosjes së treguesve të matshëm të performancës, trajnimit të stafit për etikë dhe orientim ndaj qytetarit, si dhe përmes monitorimit dhe raportimit periodik mbi ecurinë e shërbimeve. Qytetarët që përfitojnë shërbime cilësore dhe ndjejnë që zëri i tyre ka ndikim

në përmirësimin e tyre, janë më të prirë të kenë besim dhe të bashkëpunojnë me Bashkinë Dibër.

Implementimi, Monitorimi dhe raportimi

Procesi i monitorimit dhe raportimit të Planit të Veprimit realizohet në mënyrë të rregullt, me një frekuencë vjetore, dhe ka për qëllim të dokumentojë përmbushjen e aktiviteteve nga ana e punonjësve apo grupeve të caktuara përgjegjëse për zbatimin e masave të planifikuara. Monitorimi shërben për të vlerësuar nëse këto masa janë zbatuar në mënyrë efektive, si dhe për të identifikuar ndonjë ndryshim të mundshëm në kushtet institucionale apo në natyrën e risqeve që mund të kërkojnë rregullim të prioriteteve ose rishikim të vetë masave në plan. Ai gjithashtu kontribuon në përmirësimin e planifikimit për periudhat e ardhshme, nëpërmjet nxjerrjes së përvojave praktike dhe mësimave të vlefshme.

Raportimi përbën një mekanizëm sistematik që garanton ndjekjen e zbatimit të Planit të Integritetit në përputhje me afatet kohore të përcaktuara. Kjo detyrë i besohet një personi të ngarkuar nga drejtuesi i institucionit, i cili ka përgjegjësinë për të mbikëqyrur progresin dhe për të evidentuar zbatueshmërinë e masave të parashikuara. Raportimi kryhet të paktën një herë çdo gjashtë muaj, duke mundësuar ndërhyrje të shpejtë dhe masa korrigjuese në rastet kur zbatimi i ndonjë mase has në pengesa apo vonesa të pajustificuara. Ky sistem i rregullt ndihmon në ruajtjen e integritetit institucional dhe në forcimin e përgjegjshmërisë përballë risqeve të evidentuara.

Objektivi Strategjik 1: Forcimi i Kuadrit të Brendshëm Rregullator në Aspekte të Vecanta të Etikës dhe Integritetit me qëllim funksioniminin efektiv të menaxhimit të riskut, dhe përmirësimin e performancës.					
Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Faktorë të riskut	Masat prioritare Prioritet i lartë Prioritet i moderuar Prioritet i ulët	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatimin e masës	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për zbatimin e aktivitetëve
1	Mungon Plani Strategjik i Zhvillimit të Bashkisë.	Operacionale/ Strategjik		- Hartimi, konsultimi dhe miratimi i Planit Strategjik të Zhvillimit të Bashkisë Dibër. - Publikimi i këtij plani në Programin e Transparencës.	Grup Punë për hartimin e Planit Strategjik të Zhvillimit Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik Koordinatori për të Drejtën e Informimit (Gjashtëmujori i parë 2026)

	Mungon Plani I Integritetit			1.Aprovimi i Pl-së së hartuar nga Këshilli Bashkiak. 2.Njohja e gjithë stafit dhe palëve të interesit me dokumentin e Pl-së. 3.Publikimi i Pl-së në faqen zyrtare të Bashkisë, Programi i Transparencës. 4.Caktimi i Koordinatorit të Zbatimit të Planit; 5.Monitorimi i zbatimit të planit dhe raportimi i tij në baza vjetore	Kryetari, GPI-ja e formuar me urdhër të Kryetarit Koordinatori për Zbatimin e Planit të Integritetit Duke nisur nga Janari 2026 dhe në vazhdimësi
2	Nxitje e një politikë për promovimin e stafit ekzistues në kuadër të procesit të ngritjes në detyrë.	Burimet Njerëzore/Strategjik	Mesatar	Hartimi dhe miratimi i një politike të brendshme për promovimin , ngritjen në detyrë, lëvizjet paralele.	Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (6 mujori i parë

					2026)
3	Rregullat për menaxhimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të bashkisë nuk janë miratuar.	Operacional/ Financiar	Mesatar	1. Hartim i udhezuesi/rregullore për menaxhimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të bashkisë duke iu referuar Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit . 2. Organizimi i sesioneve informuese për stafin e përfshirë në lidhje me rregullat e miratuara. Përfshirja e tyre në Planin Vjetor të Trajnimeve.	Sherbimeve mbeshtetese(burimet Njerëzore) Drejtoria e të Ardhurave, Sektori i Pronave Publike, (Gjashtëmujori I pare 2026)

4	Rregullorja e Brendshme e bashkisë është e papërditësuar me funksionet per parandalimin e KI/sinjalizimit të institucionit dhe nuk përcakton qartë linjat e hierarkisë.	Operacional/ Ligjor dhe Kontraktual	Mesatar	Rishikimi i Rregullores së Brendshme të Bashkisë Dibër për përfshirjen e çdo pozicioni pune të parashikuar në strukturë apo funksioneve që jepen për njësitë përgjegjëse për parandalimin e K.Interesit, sinjalizimit, koordinatorëve për informimin dhe konsultimin.	Grupi i Punës për rishikimin e rregullores (Gjashtëmujori i parë 2026)
---	---	-------------------------------------	---------	--	--

5	Mangësi në Kodin e Etikës së Administratës së Bashkisë në raport me kërkesat e kuadrit rregullator përkatës.	Operacional/ Strategjik	Mesatar	Harmonizim i Kodit të Etikës në përputhje me Ligjin Nr.9131/2003, VKM-ja nr. 714/2004, si dhe kuadrit rregullator horizontal për shmangien e konfliktit të interesit, mbrojtjen e të dhënave personale etj. Organizimi i një trajnimi të brendshëm mbi Kodin e Etikës. Parashikimi i këtij trajnimi në planin vjetor të trajnimeve	Grupi i Punës për Rishikimin e Kodit të Etikës Drejtoria Sherbimeve Mbeshtetese(burimet Njerëzore) (Gjashtëmujori i dytë 2025)
---	--	-------------------------	---------	--	---

6	Detyrat e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, linjat e komunikimit, afatet dhe ndarja e përgjegjësi mes tij dhe strukturave të tjera, nuk janë të parashikuara në Rregulloren e Brendshme.	Operacional/ Informacioni	Mesatar	1. Parashikimi në Rregulloren e Brendshme i detyrave dhe përgjegjësi të koordinatorit për të drejtën e informimit dhe linjat e komunikimit me strukturat e tjera, afatet dhe përgjegjësitë për kthimin e përgjigjeve. 2. Organizimi i takimeve ndërgjegjëseuse /informuese me personelin e bashkisë mbi detyrimet që rrjedhin nga ligji për të drejtën e informimit. Përfshirja e tyre në planin vjetor të trajnimeve.	Grupi i Punës për rishikimin e Rregullores Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (Gjashtëmujori i parë 2026)
---	---	---------------------------	---------	--	--

7	Mungesa e rregullave të brendshme për funksionimin e GMS-së si një organ kolegjal në bashki, duke vene ne funksion te plote EMP si pjese e pandashme ne planifikimin buxhetor	Operacional	Mesatar	Hartimi dhe miratimi i rregullave të brendshme të funksionimit të GMS-së si organ kolegjal në Bashki, si dhe përcaktimi i detyrave dhe përgjegjësie përkatëse.	Grup Pune i krijuar me urdhër të Kryetarit të Bashkisë. (Gjashtëmujori dyte 2025)
---	---	-------------	---------	--	--

Mungon Struktura e dedikuar per menaxhimin e riskut te integritetit. Kuadri i brendshëm rregullator nuk rregullon procedurën e sinjalizimit, hetimit dhe mbrojtjes së sinjalizuesve ne Bashkinë Dibër,	Operacional/ Ligjor dhe Kontraktual	1. Rishikimi i Rregullores së Brendshme për të përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e njësisë përgjegjëse për hetimin e sinjalizimit dhe mbrojtjen ndaj hakmarrjes. (reference ligji 60/2016) 2. Ngritja e strukture se dedikuar per manaxhimin e riskut 3. Miratimi i formularëve për sinjalizimin dhe formularët për kërkesën për mbrojtjen nga hakmarrja sipas modelit të ILDKPKI-së. 4. Miratimi i regjistrave për sinjalizimin dhe të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja sipas modelit të ILDKPKI-së. 5. Hartim i Rregullores për hetimin Administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit, si përshatje e modelit të ILDKPKI-së.	Grupi i Punës i caktuar me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Auditi i Brendshëm Drejtoria Juridike, Prokurimeve dhe Sektori TIK (Gjashtëmujori i parë 2026)
--	--	--	---

9	Rregullore e dokumentacionit të Bashkisë Dibrë e papërditësuar me kërkesat dhe formatet e reja të dokumentacionit, të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	Operacional	Mesatar	Rishikim i Urdhërit të Kryetarit Nr. 19, datë 19.1.2018 "për miratimin e rregullave të organizimit të punës me dokumentacionin administrativ në përputhje me etikën e trajtimit të tij", për të siguruar harmonizimin me Rregulloren e Njehsuar të Punës dhe Modelet e Dokumenteve Administrative miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.	Drejtoria Juridike, Prokurimeve Publike, Arkivi (Gjashtëmujori i dytë 2026)
---	--	-------------	---------	--	---

Objektivi Strategjik II: Përmirësimi i procedurave të kontrollit dhe monitorimit, Forcimi i integritetit në proceset dhe fushat funksionale të Bashkisë, (Risiko dhe aktivitetet)					
Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Faktorë të riskut	Masat prioritare Prioriteti i lartë Prioriteti i moderuar Prioriteti i ulët	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatimin e masës	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për zbatimin e aktivitetëve
	Menaxhimi Financiar				
10	Vonesa gjatë procesit të hartimit dhe miratimit të PBA-së dhe Buxhetit Vjetor.	Burimet Njerëzore/ Strategjik	Mesatar	Koordinim i vazhdueshëm për respektimin e kalendarit të hartimit dhe miratimit të PBA-së dhe Buxhetit Vjetor nga të gjitha palët e përfshira.	GMS/Drejtorja e Financës dhe Buxhetit, Drejtoritë e tjera të përfshira, Këshilli Bashkiak. (2026 dhe çdo vit buxhetor)

11	Konsultim jo i gjerë me komunitetin në procesin e përcaktimit të prioritetëve gjatë planifikimit buxhetor Mars-qershor-shtator)	Operacional/ Financiar	Mesatar	Zhvillimi i konsultimeve të zgjeruara me banoret e bashkisë dhe njërive administrative gjatë përcaktimit të prioritetëve për të siguruar përputhshmëri sa më të lartë të buxhetit dhe nevojave të komunitetit.	Drejtorja e Financës, Drejtoritë e tjera të përfshira, Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin, financa, Këshilli Bashkiak (2026 dhe çdo vit buxhetor)
12	Problematika në procesin e kryerjes së shpenzimeve	Operacional/ Financiar	Mesatar	1. Kontrollë periodike nga eprorët përkatës në lidhje me respektimin e procedurave të thesarit për kontrollin e shpenzimeve sipas Ligjit për Financat vendore 2. 2. Monitorimi i buxhetit bazuar në informacionin e viteve të kaluara dhe vitit buxhetor aktual dhe propozimi i ndryshimeve përkatëse në KB.	Drejtorja e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria Juridike 2026

13	Parashikim jo realist i planit te te ardhurave	Operacional/ Financiar	Mesatar	Planifikimi i taksave dhe tarifave, si dhe i të ardhurave dhe masave për mbledhjen e tyre, në përputhje me analizën e riskut dhe të dhënave faktike të treguesve në vitet e mëparshme.	Drejtoria(sektori) e të Ardhurave, (Gjashtëmujori i dytë 2025 e në vijim)
14	Infrastrukturë e papërshtatshme fizike dhe IT për administrimin e dokumenteve financiare të bashkisë.	Mjedisi/ Informacioni	Mesatar	1. Sigurim i infrastrukturës së domosdoshme fizike (ambient i dedikuar) dhe teknologjike për administrim të efektshëm të dokumenteve financiare.	Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit (2027)

15	Ndryshime të vazhdueshme në planin e prokurimeve që vështirësojnë zbatimin e tij.	Burimet Njerëzore/ Strategjik		Përcaktimin e Rregulloren e Brendshme i detyrimit të kryerjes se një analize para çdo ndryshimi të propozuar në regjistrin e miratuar të prokurimeve publike. Analiza mbi bazë precedentesh të reflektohet në parashikimet për vitet në vijim.	Drejtoria Juridike, e Prokurimeve Publike dhe TIK, Grupi i Punës për rishikimin e Rregullores (2026)
	Fusha e Kontrollit, Auditimit dhe i Mekanizmave kundër korrupsion				

16	Mungesa e Kartës së Auditimit të Brendshëm.	Operacional/ Ligjor dhe Kontraktual	Mesatar	Hartimi dhe miratimi i Kartës së Auditimit të Brendshëm dhe publikimi i saj në PT.	Kryetari i Bashkisë, Sekretari i Përgjithshëm, Auditi i Brendshëm Koordinatori për të Drejtën e Informimit (Gjashtëmujori i parë 2026)
----	---	---	---------	--	--

17	Mungesa e hartimi të Strategjisë për Menaxhimin e Riskut.	Operacional/ Strategjik		Hartimi dhe miratimi i Strategjisë për Menaxhimin e Riskut.	Kryetari i Bashkisë GMS (Gjashtëmujori i dytë 2026)
18	Njësia përgjegjëse për hetimin e sinjalizimit dhe mbrojtjen ndaj hakmarrjes nuk është ngritur në bashki.	Operacional/ Strategjik		Ngritja e njësive përgjegjëse për hetimin e sinjalizimit dhe mbrojtjen ndaj hakmarrjes.	Kryetari i Bashkisë (Gjashtëmujori i dytë 2026)

							Koordinatori për tëDrejtn e Informimit, Auditi i Brendshëm (Gjashtëmujori i parë 2027)
							Publikimi, duke respektuar konfidencialitetin, e raporteve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, në programine transparencës.
						Mesatar	
						Operacional/ Reputacional dhe Imazhi	
						Mungesë transparence mbi rezultatet e kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm të Bashkisë.	
19							